



Përshkrim i ofertave të përkujdesjes 2021/2022



Elementi i përkujdesjes 1: *Koha e arrijtes*

Ora 6.45 deri 8.10

Një nga kujdestarët është i pranishëm dhe i pret nxënëset dhe nxënësit. Ekziston mundësia për të ngrënë një mëngjes të sjellë me vete, për të zgjidhur i pavarur detyrat e shtëpisë, për të lexuar ose luajtur.



Elementi i përkujdesjes 2: *Ngrënie e drekës dhe përkujdesje*

Ora 11.40 deri 13.20

Nxënëset dhe nxënësit marrin një ushqim dreke të shëndetshëm. Pas kësaj të gjithë bashkë vendosin gjërat në vend. Përkujdesja zgjat deri sa fillon përsëri mësimi i pasdrekës. E hëna, e marta, e enjta vullnetarisht të bëjë gjimnastikë J+S Kids. Për fëmijët që nuk kanë mësim pasdrekë elementi i përkujdesjes 2 mbaron në orën 13.20. Ata kthehen në shtëpi ose vizitojnë elementin e përkujdesjes 3.



Elementi i përkujdesjes 3: *Përkujdesje për kohën menjëherë pas drekës*

Ora 13.20 deri 14.55

Nxënëset dhe nxënësit munden të zgjidhin detyrat e tyre të shtëpisë në mënyrë të pavarur në ambientet e përkujdesjes (pa u mbikqyrur). Më pas janë në dispozicion lojra të ndryshme. Elementi i përkujdesjes 3a mbaron me pauzën e mësimi të pasdrekës.



Elementi i përkujdesjes 4: *Vakt ushqimi i ndërmjetëm dhe përkujdesje*

Ora 14.55 deri 18.00

Nxënëset dhe nxënësit marrin një vakt ushqimi të ndërmjetëm (Zobig). Më pas ata munden të zgjidhin detyrat e tyre të shtëpisë në mënyrë të pavarur në ambientet e përkujdesjes (pa u mbikqyrur). Për nxënëset dhe nxënësit e tjerë dhe më vonë edhe për ata që i kanë kryer detyrat e shtëpisë janë në dispozicion lojra të ndryshme. Në pasdrekën e vonë nxënësit kthehen në shtëpi sipas planit të tyre individual. Ky interval kohor zgjat deri në mbarimin e strukturave ditore maksimumi deri në orën 18.00.



Detyrat e shtëpisë në Ufzgiclub (klubi i detyrave të shtëpisë) për ciklin fillor

Elementi i përkujdesjes **U_a: 1. – 4. Primarstufe**: Ora 13.20 deri 14.05 të hënën, të martën dhe të enjten

Në Ufzgiclub nxënëset dhe nxënësit e ciklit fillor zgjidhin në mënyrë të pavarur detyrat e tyre të shtëpisë nën mbikqyrje. Personi kujdestar parimisht kujdeset që fëmijët të mund t'i kryejnë në qetësi detyrat e tyre të shtëpisë. Ai kontrollon nëse janë kryer detyrat e shtëpisë, por nuk ka përgjegjësinë e ndihmës dhe të korigjimit. Për të ndihmuar është i pranishëm një mësimdhënës. Pas mbarimit të detyrave të shtëpisë fëmijët kalojnë në elementin e përkujdesjes 3 ose shkojnë në shtëpi.



Detyrat e shtëpisë në Ufzgiclub (klubi i detyrave të shtëpisë) për ciklin fillor

Elementi i përkujdesjes **U_b: 1. – 4. Primarstufe**: Ora 15.15 deri 16.00 të hënën, të martën dhe të enjten

Elementi i përkujdesjes **U_c: 1.- 4. Primarstufe**: 16.05 deri 16.50 të hënën, të martën dhe të enjten.

Ufzgiclub fillon në orën 15.15 dhe mbaron maksimumi në orën 16.50. Pas mbarimit të detyrave të shtëpisë fëmijët kalojnë në elementin e përkujdesjes 4 ose shkojnë në shtëpi.



Orë e të mësuarit për ciklin fillor L_Primar:5. – 6. Primarstufe: 16.10 deri 17.10 të hënën, të martën dhe të enjten Në Ufzgiclub nxënëset dhe nxënësit e ciklit fillor zgjidhin në mënyrë të pavarur detyrat e tyre të shtëpisë. Personi kujdestar parimisht kujdeset që fëmijët të mund t'i kryejnë në qetësi detyrat e tyre të shtëpisë. Ai kontrollon nëse janë kryer detyrat e shtëpisë, por nuk ka përgjegjësinë e ndihmës dhe të korigjimit. Pas mbarimit të detyrave të shtëpisë fëmijët kalojnë në elementin e përkujdesjes 4 ose shkojnë në shtëpi. Elementi i përkujdesjes

Orë e të mësuarit për ciklin sekondar L_Sek: Sekondar dy here ne javë sipas planit të tyre individual.